



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU - BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.8/23

G.JYKATA THEMELORE NE PRIZREN, kryetarja e gjykatës, Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore parashtruar nga ana e ankuesit F.S., nga fshati B..... Komuna e Dragashit të cilin e përfaqëson A.B.O., nga Zyra Legale A.....&A....., nga Prishtina ndaj gjyqtarës S.K., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren në Dega në Dragash, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarës së lartcekur sipas lëndës C.nr. 141/22, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt. 14.04.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ankuesit (paditësit) F.S., nga fshati B....., Komuna e Dragashit ndaj gjyqtarës S.K., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren në Dega në Dragash.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës F.S., nga fshati Brrut Komuna e Dragashit të cilin e përfaqëson A.B.O., nga Zyra Legale A.....&A....., nga Prishtina në ankesën e tij drejtuar KGJK-së e cila më pas është përcjellë tek Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prizren ka cekur se pranë Gjykatës Themelore në Prizren Dega në Dragash është iniciuar procedura civile me kërkesë për caktim të masës së sigurisë C.nr. 141/22 ku paditës është F.S.,. Me dt. 01.11.2022 Gjykata e Apelit në Prishtinë ka nxjerrë aktvendim Ac.nr.6740/22 me të cilin është anuluar aktvendimi për masën sigurore C.nr. 141/22 dhe rasti është kthyer në rivendosje në Gjykatën Themelore në Prizren Dega në Dragash. Pas kësaj date Gjykata Themelore në Dragash nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në lidhje me këtë kërkesë edhe pse disa herë në formë të shkruar janë drejtuar gjykatës për caktim të seancës ose për ndonjë vendim gjyqësor nuk ka pasur ndonjë reagim nga gjykata. Sipas ankuesit konsiderojnë se masat sigurore janë të natyrës urgjente dhe se të njëjtat duhet të trajtohen në këtë mënyrë dhe se ka pasur zvarritje të lëndës nga ana e gjyqtarës së rastit me një veprim të tillë të mos veprimit .

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesën drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtarë e çështjes S.K., si dhe ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës.

Gjyqtarja S.K., në deklaratën e saj ka cekur se ajo është e vetmja gjyqtare që punon në Gjykatën Themelore në Prizren Dega në Dragash dhe se është e ngarkuar me lëndë të gjitha lëmitë të cilat i ka kjo gjykatë. Lënda për të cilën është parashtruar ankesa është e natyrës civile dhe ka të bëjë me kompensim demi me propozim të masës së sigurisë ku si paditës është F.S., me përfaqësues të autorizuar av. A.B.O., dhe të paditur Firma "B....." SHPK nga fsh. Pilavë Komuna e Dragashit

të cilin e përfaqëson avokatura "KKKKK" dhe m; pas av. A.P., nga Dragashi. Pas pranimit të padisë me aktvendim oshta caktuar Masa e sigurisë me dt. 05.08.2022 ku pala e paditur ka parashtruar anekso dhe lënda C.nr. 141/22 oshta përcjelle në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Gjykata e Apelit ka vendosur me Aktvendim Ac.nr.6740/22 me dt. 01.11.2022 dhe e ka kthyer lëndon në Gjykatën e Dragashit me dt 11.11.2022. Aktvendimi eksponuar palëve (me datë 11.11.2022., 22.11.2022m dhe 23.11.2022,) ditë me pas tek gjyqtarja është dorëzuar me dt. 05.01.2023. Më tej Gjyqtarja ka cekur se oshtë e parapara me ligj londit të cilat kthehen në rigjykim duhet të caktohen në afatin ligjor prej 30 ditësh nga dita kur e ka pranuar lëndon në rivendosje, por se nom disa raste kjo nuk është e mundur pasi që ajo është e ngarkuar me lëndë të gjitha natyrave të cilat janë me prioritet dhe të natyrës urgjente (si dhunë në familje, alimentacion, kontakti me fëmijën konteste të punës dhe lëndë të tjera civile si dhe lëndë penale, përmbarrimore, trashëgimorë dhe të ndryshme) Përkundër kësaj gjyqtarja ka cekur se lëndën kontestuese e ka caktuar me dt. 06.04.2023 në ora 11.30 e cila është mbajtur në prezencë të gjithë palëve. Gjithashtu ka pohuar se deri më këtë datë janë caktuar për afërsisht 150 seanca të natyrave të ndryshme gjithmonë duke pasur parasysh prioritetin e këtyre lëndëve. Sa i përket parashtrave për urgjencë të cilat i ka cekur ankuesi ka deklaruar se të njëjtat nuk i ka pranuar nga ana e zyrës së pranimit edhe pse një shkresë është dorëzuar në gjykate me dt. 30.12.2022 të cilën zyrtari nuk i ka dorëzuar me kohe tek gjyqtarja. Në lidhje me Aktvendimin për caktimin e masës së përkohshme, kjo masë është caktuar dhe tani duhet të vazhdohet me procedurë të shqyrtimit të tërësishtë të çështjes dhe të vlerësohet vendimi i masës së përkohshme në mënyrë meritore. Andaj bazuar në të gjitha të lartcekura gjyqtarja konsideron se ka kryer punën e saj gjatë trajtimit të çështjes kontestuese brenda mundësive reale të trajtimit si dhe se nuk ka pasur për qëllim të neglizhojë ose të zvarris me qëllim të caktuar këtu çështje. Gjithsesi e njëjta është caktuar dhe është mbajtur seanca dëgjimore.

Autoriteti kompetent – Kryetarja e Gjykatës pas të gjitha veprimeve hetimore preliminare ka konstatuar se:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ka pasur baze për shkelle disiplinore pasi që pretendimet e ankuesit (paditësit) F.S., nga fshati Brrut Komuna e Dragashit të cilin e përfaqëson A.B.O., nga Zyra Legale A..... nga Prishtina nuk qëndrojnë për faktin se gjyqtari ka vendosur në kuadër të autorizimeve të tij dhe në bazë të ligjit.

Autoriteti kompetent — kryetarja e gjykatës gjatë shqyrtimit të ankesës së ankuesit F.S., nga fshati Brrut Komuna e Dragashit të cilin e përfaqëson A.B.O., nga Zyra Legale A..... nga Prishtina ka parashtruar Padi për kompensim dëmi me propozim të masës së sigurisë me dt. 27.07.2022 ku si të paditur kanë qene SHPK "B.....", Komuna e Dragashit dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Me dl. 05.08.2022 me Aktvendim CM. 141/22 është caktuar masa e sigurimit dhe vendim i cili i është ekspeduar palëve ndaj të cilës masë është parashtruar ankesa nga ana e të autorizuarit të të paditurit avokatura "K....." në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë. Lënda është përcjelle në Gjykatën e Apelit me datë 22.08.2022. Nga ana e Gjykatës se Apelit është kthyer Aktvendimi AC.nr.6740/22 me datë 08.11.2022 me vulë të pranimit të Gjykatës Themelore në Prizren — Dega në Dragash me datë 11.11.2022. Ky aktvendim është ekspeduar palëve me datë 01.11.2022, 22.11.2022, 23.11.2022 dhe 23.11.2022. Në shkresa e lëndës gjithashtu qëndron edhe parashtrësja e avokatit A.B.O., me kërkesë urgjente për vendosjen e propozimit për masën e sigurisë, e pranuar në Gjykatën Themelore në Prizren Dega në Dragash me datë 30.12.2022, ku në fund të shkresës me dorë është shënuar se e njëjta shkresë është pranuar nga referenti Z.B., me datë 23.03.2023. Gjithashtu në shkresa të lëndës është e bashkëngjitur urdhëresa për caktim të shqyrtimit kryesor me datë 06.04.2023 në ora 11:30, ku janë cekur personat që duhet të ftohen. e nënshkruar nga gjyqtarja S.K., me datë 17.03.2023. Në urdhëresë është bashkëngjitur edhe aktvendimi për dhënien e përgjigjes në padi si dhe një fletë dergese për

dorëzim personal nga ana e përfaqësuesit të të paditurit avokat A.R., nga Dragashi për dhënien e përgjigjes në padi, me datë 21.03.2023, i cili në ndërkohë pas revokimit të autorizimit të avokaturës "K.....", tani e përfaqëson të paditurin e parë.

Të gjitha pretendimet e ankuesit të cilat i ka cekur si shkelje disiplinore, autoriteti kompetent konsideron se nuk qëndrojnë për faktin se me shikimin në shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të deklaratës së gjyqtarës Sabaheta Kurteshi është vërtetuar se e njëjta është e ngarkuar shumë lëndë të natyrave të ndryshme të cilat pranohen në Gjykatën Themelore në Prizren — Dega në Dragash, si Gjyqtare e vetme dhe se gjatë tre muajve të fundit ka caktuar rreth 150 lëndë në punë, ku shumica e këtyre lëndëve janë me prioritet. Gjithsesi në shkresat e lëndës është urdhëresa për caktimin e seancës së shqyrtimit kryesor, e cila e mban datën 17.03.2023. Është jo kontestuese fakti se lëndët që kanë të bëjnë me kërkesë për caktimin e masës së sigurisë janë lëndë me prioritet dhe se gjykata duhet të veproj me urgjence, ku në këtë drejtim gjyqtarja fillimisht ka vendosur për masën e sigurisë, por vendimi i gjykatës së Apelit të Kosovës e ka obliguar që të shqyrtoj çështjen në tërësi dhe të vlerësohet kërkesa për masë dhe çështja kryesore dhe për këtë duhet që të caktohet shqyrtimi gjyqësor. Gjyqtarja për këtë qellim edhe e ka caktuar shqyrtimin kryesor me datë 06.04.2023 dhe të njëjtën e ka mbajtur në prezencë të gjithë palëve ndërgjegjëso. Pretendimet e palës ankuese se ka zvarritje në zgjidhjen e rastit nuk qëndrojnë, pasi që janë ndërmarrë veprime procedurale, respektivisht është caktuar mbajtja e seancës së shqyrtimit kryesor, është mbajtur dhe se gjyqtarja e rastit në asnjë mënyrë nuk ka pasur qellim të zvarritjen e rastit, mirëpo për shkak të ngarkesës me lëndë të natyrës penale dhe civile me prioritet nuk ka pasur mundësi që të caktoj më herët.

Për arsyet që u cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.8/2023, me cit. 14.04.2023



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk është e paraparë e drejta e ankesës.